

AGJËRIMI NË ISLAM



Broshura Islame për muajin e shejntë të Ramazanit- Botuar nga WWW.NUR-ISLAM.TK
1429/2008

PARATHENIE

Falenderimi i takon Allahut, Ate e falenderojme dhe prej Tij kerkojme ndihme dhe falje. Allahut i kerkojme mbrojtje prej veseve dhe veprave tona te keqija. Cilin e udhezoi Allahu s'ka kush e humb dhe cilin e largoi nga rruga e vertet, s'ka kush e udhezoi. Deshmoj se s'ka Zot tjeter veç Allahut, i Cili eshte Nje dhe deshmoj se Muhamedi eshte rob dhe i Derguari i Tij.

"O ju qe besuat, kinie frike Allahun me nje sinqeritet te vertet dhe mos vdisni ndryshe, vetem duke qene myslimane(besimtare)!"

"O ju njerëz! Kinie frike Zotin tuaj qe ju ka krijuar prej nje veteje(njeriu) dhe nga ajo krijoi (shoqen) e saj, e prej atyre dyve u shtuan shume burra e gra. Dhe kinie frike Allahun qe me emrin e Tij perbetoheni, ruajeni farefisni(akraballekun), se Allahu eshte mbikeqyres mbi ju."

"O ju qe besuat, permbajuni mesimeve te Allahut dhe thuni fjale te drejta. Ai(Allahu) iu mundeson te beni vepra te mira, ju shlyen juve mekatet, e kush respekton Allahun dhe te Derguarin e Tij, ai ka arritur nje sukses te madh."

"Thenia me e vertet eshte theni e Allahut, kurse udhezimi me i mire eshte udhezimi i Muhamedit. Veprat me te keqija jane ato te shpikurat, çdo shpikje eshte bidat dhe çdo bidat eshte lajthitje nga rruga e vertet, e çdo lajthitje perfundon ne Xhehenem.

Me te vertet Allahu i Lartesar i ka begatuar roberit e Tij me kete stine te begatshme, qe te mirat(veprat) shtohen, te keqijat shlyhen, ngriten gradat, shpirtat e besimtareve drejtohen drejte te dashurit te tyre, me te vertet ka shpetuar a ii cili e pastron shpirtin e tij dhe ka pesuar ai i cili e njollose shpirtin e tij. Me te vertet Allahu i Lartesar i ka krijuar krijesat qe ta adhurojne Ate, ngase thote Allahu i Lartesar: "Nuk i kam krijuar Xhinet dhe Njerezite per asgje tjeter vetem se te me adhurojne Mua."

Prej adhurimeve te medha eshte agjerimi ku Allahu i Madheruar i ka oblihuar roberit e Tij ku thote: "O ju qe besuat, agjerimi u eshte bere obligim sikurse qe ishte obligim edhe i atyre qe ishin para jush, keshtu qe te beheni te devotshem. . . " Dhe i ka stimuluar ata duke thene: "Mirpo, po qe se e dini, agjerimi eshte me i mire per ju. . ."

Gjithashtu i ka udhezuar ne mirnjohjen ndaj Tij, per obligueshmerine e Agjerimit ku thote: "Qe ta plotesoni numrin, ta madheroni Allahun per ate se u udhezoi dhe te falenderoni. . ."

Ju ka beret e dashur dhe ju ka lehtesuar atyre qe shpirtave te tyre t'ju vie rende, largimi nga te perditshmet e zakonshme, thote Allahu i Madheruar: "(Jeni te obliguar) Dite te caktuara. . ."

*I ka meshiruar dhe liruar nga veshteresite dhe mundimet e ndryshme, duke thene:
" ... ndersa kush eshte i semure ose ne udhetim, le te agjeroje aq dite ne ditet e
mevonshme."*

*Andaj nuk duhet te çuditemi qe zemrat e besimtareve ne kete muaj pranohen prej
Zotit te tyre te Meshirshem, frogohen nga denim ii Tij dhe shpresojne ne meshiren e Tij
gjitheperfshirese.*

*Pasi qe vlera dhe rendesia e ketij ashurimi eshte shume e madhe ateher eshte e
domosdoshme qe ti njohim rregullat lidhur me kete muaj, qe se paku muslimani te kete
njohuri per ate qe eshte farz (obligim) per te dhe ta kryej ate. Ajo eshte haram (e ndaluar)
per te, te larohet nga ajo dhe ajo qe eshte mubah (e lejuar) te mos e ngushtoje veten ne
ndalimin prej saj.*

*Kjo brochure permban ajken e rregullave lidhur me agjerimin qe e kemi shkruar ne pika
te shkurtera, ndoshta Allahu i Madheruar do te mundeson te kene dobi prej ketyre
rregullave vellezeri dhe motrat e mi musliman.*

FALENDERIMET I TAKOJNE ZOTIT TE BOTRAVE...!

Përmbajtja:

Agjerimi ne Islam

Kushtet e agjerimit te Ramazanit

Gjerat qe e prishin agjerimin

Personat qe mund te hane ne Ramazan dhe rregulla te posaqme per ta

Vlerat e Ramazanit

Edukimi i femijeve ne Ramazan..

Dobite shendetesore te Agjerimit

Aspektet mjekesore te Agjerimit ne Islam

Studime ne agjerimin Islam

Agjerimi per pacintet-Keshilla udhezuese per pacient

Rendesia e hurmave per shendetin e njeriut

Disa qeshtje gjate muajit te Ramazanit

AGJERIMI NE ISLAM



Agjërimi është një karakteristikë, morale dhe shpirtërore në Islam. Në kuptimin e plotë të fjalës, Agjërimi do të thotë të përmbajtur "tërësisht" nga ushqimi, pirja, mardhëniet intime si dhe pirja e duhanit prej syfyrit deri në iftar, gjatë tërë muajit të Ramazanit (muaji i nëntë sipas kalendarit hënor). Por nëse ne e kufizojmë domethënien e agjëritimit në kuptim të drejtëperdrejtë, ne do të bënim një gabim të madh. Më poshtë janë domethëniet qenësore të agjëritimit në Islam:

1. Ramazani i mëson njeriut principin e dashurisë së sinqertë, sepse kur ai e zbaton agjërimin, ai e bën atë për dashurinë e thellë të mbrendshme ndaj Zotit. Njeriu që e do me të vërtetë Zotin është njeri që vërtet e din se çka është dashuria.
2. Ai e pais njeriun me ndjenjë kreative të shpresës dhe një botë kuptim optimist mbi jetën, sepse kur ai agjëron, shpreson në falje nga Zoti dhe kërkon mirësinë e Tij.
3. Ai e mbush njeriun me vrytyt të sinqertë të devoteshmërisë efektive, përkushtim të ndershëm dhe afësi të Zotit, sepse kur ai agjëron, ai e bën atë për Zotin dhe vetëm për hirë të tij.
4. Ramazani kultivon te njeriu vigjilencë dhe vetëdije të fuqishme, sepse personi e mban agjërimin në sekret më mirë se sa në publik. Veqanërisht në Agjërim, nuk ka autoritet tokësor për të kontrolluar sjelljet e njeriut ose për ta detyruar atë në zbatimin e Agjëritimit. Agjëruesi e mban Agjërimin për falje nga Zoti dhe për të plotësuar vetëdijen e tij duke qenë besnikë në fshehtësi dhe publik. Nuk ka rrugë më të mirë për të përsosur një vetëdije të fuqishme të njeriut.
5. Ramazani e mbush njeriun me durim dhe vetëmohim, përmes Agjëritimit ai ndjen dhembjet e humbjes, por ai u qëndron atyre durueshëm.
6. Ai është një mësim efektiv në përqëndrim, vetëpërmbajtje dhe forcën e vullnetit.
7. Agjërimi gjithashtu i siguron njeriut një shpirt të sinqertë me mendje të kthjellët dhe trup të ndritur.
8. Ai i tregon njeriut rrugën e re të ruajtjes së diturisë.
9. Ramazani i jep mundësinë njeriut të kontrollojë mjeshtërinë e përshtatshmërisë. Në lehtë mund të kuptojmë se qështja e zbatimit të Agjëritimit, e bën njeriun të ndërrojë, rrjedhën e jetës së përditshme të tij.
10. Ai e ngulitë fortë një disiplinë dhe mbijetesë të shëndetshme.
11. Formon te njeriu shpirtëmirësi të vërtetë në shoqërinë që i takon, në miqësi dhe vëllazëri, të barabartë para Zotit me mirë se para ligjit.
12. Ramazani është një porosi nga Zoti për vetë-qetësi dhe vetë-disa muslimanë, mjerishtë, nuk e zbatojnë Agjërimin ose më mirë të themi e kanë pranuar qëndrimin e të qenit indeferentë. Në anën tjetër, disa nga ata që e zbatojnë atë, nuk e bëjnë siç në të vërtetë e ka domethënien, dhe si rezultat përfitojnë shumë pak dobi, në fakt jo të gjitha dobitë. Kjo

është pse sot disa musliman nuk ndjenjë kënaqësi,privilegje reale nga Agjërimi.

Tani me është e ditur se koha e obliguar për Agjërim është muaji i Ramazanit.Koha e zbatimit të Agjërimit ditor fillon para agimit dhe perfundon me perëndimin e diellit.Kuptohet ka kalendarë të cilët tregojne kohën e saktë të agjërimit(vaktia e Ramazanit),në mungesë të këtyre duhet ti referohemi orës dhe pozicionit të diellit,gazetave vendore ose zyreve të institutit metereologjik etj
Agjërimi i Ramazanit është obligim dhe përgjegjësi për cdo musliman të shëndoshë,por ka edhe kohë të tjera kur agjerimi eshte i rekomanduar ne kontestin vullnetar,ashtu siq ka vepruar i Dërguari i Allahut,Muhamedi a.s.Këto janë e hëna dhe e enjëta e cdo jave,ca ditë në sicilin muaj,në dy muajt para ardhjes së Ramazanit(Rexheb,Shaban),gjasthtë ditë në përcjellje të Ramazanit pas Fitër Bajramit.Përveq kësaj,ka gjithmonë shpërblim për agjërimin e ndonje dite të muajve të vitit,në përjashtim të ditës së Bajramit dhe të premtëve,ku në rast të tillë asnjë musliman nuk duhet të agjërojë.Megjithatë , ne duhet të përsërisim obligimin e vetëm-agjërimin e Ramamzanit,i cili mund të jetë 29 ose 30 ditë,varësisht nga pozicionet e hënës.Kjo është shtyllë e Islamit dhe cdo dështim në zbatimin e tij pa arsye të qëndrueshme është mëkat i rënde tek Zoti.

KUSH DUHET TE AGJEROJ?

Agjërimi i Ramazanit është obligim për cdo musliman mashkull ose femër,që i plotëson këto kushte:

- 1.të jetë mentalisht dhe fizikisht i shëndoshë,që d.m.th të jetë normal dhe i aftë.
- 2.të ketë hyrë me moshën e pubertetit dhe pjekurisë,e cila është përafërsisht rreth 12,14 vjet..Fëmijët nën këtë moshë duhet të inkurajohen të fillojnë këtë praktikë të mirë në shkallë më të lehtë,kështu që ata kur të arrijnë moshën e pubertetit,do të jenë mentalisht dhe fizikisht të përgatitur që ta kryejnë agjërimin.
- 3.të jetë i pranishëm në një venbanim:në shtëpi,në qytet apo në vende pune.Kjo do të thotë për të mos qenë në udhëtim rreth 50 mile e më shumë.
- 4.të jetë i sigurve se agjërimi është vështirë të mbahet,dhe nuk i shkakton dëm fizikë dhe mental,të tjerat janë reagime normale si:uria,etja ,etj.

PERJASHTIMI NGA AGJERIMI

Nga agjërimi janë të liruar:

- 1.Fëmijët nën moshën e pubertetit(pjekurisë)
- 2.Njerëzitë e cmendur të cilët janë të papërgjegjshëm për atë që kanë bërë.Njerëzitë e këtyre kategorive janë të përjashtuar nga agjërimi ose ndonjë zëvendësim .
- 3.Njerëzitë në moshë të vjetër (burra dhe gra)dhe shëndetligë të cilët nuk mund të përballojnë agjërimin.Këta njerëz jenë të liruar nga agjërimi,por ata duhet të përpjekjen ,të paktën të ushqejnë një të varfër së paku një racion ditor,ose kompensimin e saj me të holla për këtë vlerë.
- 4.Njerëzitë e sëmurë,shëndeti i të cilëve nuk e përballon agjërimin,nuk janë të obliguar ta bëjnë këtë.
- 5.Udhëtarët mund të prishin agjërimin përkohësishtë deri sa ata janë në udhëtim,por

duhet ta kompensojnë atë më vonë ditë me ditë.

6.Gratë shtatëzëna dhe gratë që janë duke i ushqyer fëmijët e tyre me gjii,ato mund të prishin agjërimin ,nëse agjërimi dëmton ato ose fëmijët e tyre.Këto ditë duhet të zëvendësohen më vonë.

7.Gratë në periudhën e menstruacioneve duhet patjetër ta shtyejnë agjërimin deri sa të shërohen dhe më pastaj ti kompensojnë ditët e lëna me ditë.

Agjërimi i ndonjë dite të Ramazanit bëhet i pavlefshëm nëse qëllimisht hamë,pimë,pimë duhan ose kemi mardhënie intime gjatë ditës.Agjërimin e prishë edhe marrja e qfardo gjëje përmes gojës apo qfardo pjese të mbrendshme të trupit.Dhe nëse kjo është bërë me qëllim dhe pa arsye të qëndrueshme ,ky është një mëkat i madh.Ndërsa,nëse ndokush,hanë ose pinë diqka që zakonishtë e prishë agjërimin,por që këtë e ka bërë nga harresa,agjërimi i tij mbetet i vlefshëm.

Allahu i madheruar thote ne Kur'an : “O ju që besuat, agjërimi u është bërë obligim sikurse që ishte obligim edhe i atyre që ishin para jush, kështu që të bëheni të devotshëm,jeni të obliguar për) Ditë të caktuara, e kush është i sëmurë prej jush ose është në udhëtim (e nuk agjëroi), atëherë ai (le të agjërojë) më vonë aq ditë. E ata që i rëndon ai (nuk mund të agjërojnë), janë të obliguar për kompensim, ushqim (ditor), i një të varfëri ai që nga vullneti jep më tepër, ajo është aqë më mirë për te. Mirëpo, po që se dini, agjërimi është më i mirë për ju.(Bekare:183-184)

Ebu Hurejre r.a. transmeton se Pejgamberi s.a.v.s. ka thene: “Kush i kalon netet e Ramazanit duke bere ibadet,duke qene i bindur ne besimin islam,dhe duke pasur per qellim te sinqerte,do t`i falen te gjitha gabimet e tij te meparshme.”

Ebu Hurejre r.a. thote se Pejgamberi s.a.v.s. ka thene: “Kush e agjeron muajin e Ramazanit,duke qene i bindur ne besimin islam dhe duke i kryer obligimet islame,do t`i falen te gjitha gabimet e tij te meparshme.”

Ebu Hurejre r.a. thote se i Derguari i Allahut s.a.v.s. ka thene: “Kur te vije muaji i Ramazanit,happen dyert e Xhennetit dhe mbyllen dyert e Xhehenemit dhe shejtanet lidhen me zingjir”.

JO VETEM URI DHE ETJE



"Muaji i Ramazanit që në të filloi të shpallet Kur'ani që është udhërrefyes për njerëz dhe sqarues i rrugës së drejtë dhe dallues(i të vërtetës nga gënjeshtria)"Kur'an(2:185)

Natyrisht muaji i bekuar Ramazan ,kërkon agjërim nga shumica e muslimaneve.Duke i dheënë theks shmangies nga ushqimi,përmbajtjes nga pirja e duhanit dhe lëngjeve ,përmbajtjes nga mardhëniet intime gjatë oreve të ditës,ne ndonjëhere harrojmë shumë aspekte të tjera të rëndësishme në

këtë kohë të shenjtë.

Kushtet e agjerimit te Ramazanit

- 1.Islami:pra me te nuk obligohet jobesimtari deri sa te hyje ne Islam.
- 2.Mendja e shendoshe:Nuk obligohet me agjerim i krisuri(i semuri mental)
- 3.Pjekuria:Nuk obligohet i mituri deri sa te beht i pjekur(i moshes madhore),mirpo te miturin duhet urdheruar per ta mesuar ate.
- 4.Mundesia per agjerim:nuk obligohet te agjeroje i moshuari,per shkak te shendetit(d.m.th ne qofte se nuk mundesi te agjeroj),dhe i semuri i cili nuk shpreson te sherohet,ndersa si kompensim per kete ata duhet te ushqejne per çdo dite nje te varfer ose te mjere.
- 5.Dallimi i gjerave:nuk ben te agjeroj i mituri qe nuk di te dalloje gjerat.
- 6.Nderprerja e menstruacioneve:nuk obligohet te agjeroje gruaja me menstruacione deri sa te nderpritet gjaku.
- 7.Nderprerja e gjakut te lehonise:nuk obligohet ajo grua qe eshte lehoni deri sa te pastrohet.
- 8.Te beje nijet te agjeroje muajin e plote,ndersa me mire eshte te beje nijetin per çdo dite qe agjeron.

Gjerat qe e prishin agjerimin

- 1.Ngrenia dhe pirja qellimisht.
- 2.Depertimi i ujit ne fyt permes hundes.
- 3.Futja e gjesendi ne trup,edhe nese nuk eshte nga goja ose hunda.
- 4.Vjellja e shkaktuar qellimisht.
- 5.Dalja e gjakut te menstruacioneve dhe te gjakut te lehonise.
- 6.Mardheniet seksuale gjate dites se agjerimit.
- 7.Ejakulimi jashte gjumit.

Personat qe mund te hane ne Ramazan dhe rregullat e posaqme per ta



1. I semuri qe demtohet nga agjerimi dhe udhetari te cilit i lejohet shkurtimi i namazit: Ngrenia (joagjerimi) eshte me mire per keta te dy, por ata me vone duhet ti kompensojne keto dite. E ne qofte se agjerojne, pranohet agjerimi i tyre.

2. Gruaja me t'permuajshmet e saj ose lehona nuk duhet te agjerojne, por ato pastaj keto dite i kompensojne. Ne qofte se agjerojne, kjo nuk pranohet prej tyre.

3. Shtatzena dhe gruaja qe jep gji: Ne qofte se ato frikesohen per femijet e tyre, ateher nuk agjerojne, dhe per çdo dite ushqejne nje te varfer. Ne qofte se agjerojne, pranohet agjerimi i tyre.

Gjithashtu, ne qofte se frikesohen per veten e tyre nuk agjerojne, por pastaj e kompensojne ate (agjerimin). Edhe i moshuari qe nuk mund te agjeroje, kurse si kompensim ushqejne per çdo dite nje te varfer me nje kile e gjysme, perafersisht, nga ushqimi i atij vendi..

VLERAT E RAMAZANIT

Muaji i Ramazanit eshte nje muaj te cilin Allahu i Madherishem e dalloi dhe e veçoi nga muajt e tjere me veçori te shumta, muaj i gezimeve, i bashkimit te muslimaneve, dhe meshires ndermjet tyre, ky eshte muaj i solidaritetit, muaj i durimit, muaj i fitores dhe i begatite te shumta, sepse All-llahu i Madherishem ne kete muaj i shton begatite e Tij mbi roberit e vet.

Vlera me e madhe e ketij muaji padyshim eshte ajo se ne kete muaj ka zbritur Kurani Fisnik, sikur edhe thote All-llahu i madherishem: "Muaji i Ramazanit qe ne te filloi (te shpallet) Kur'ani qe eshte udherrefyes per njerezite dhe sqarues i rruges se drejte dhe dallues (i se vertetes nga genjeshtra)."

Per shkak te vleres se madhe te ketij muaji i Derguari i All-llahut Muhamedi s.a.v.s. i lutej All-llahut qe tia mundesoje arrijten e ketij muaji: "Pejgamberi s.a.v.s. lutej qe tia arrinte muajin e Ramazanit dhe thoshte: "O Zoti im, na shto begatite e Tua ne muajin Rexhep dhe Sha'ban dhe na mundeso te arrijme muajin Ramazan."

Pejgamberi s.a.v.s. para se te arrije ky muaj i Madherishem i pergezonte shoket e tij me arrijten e Ramazanit dhe njeherit i perkujtonte me vlerat e ketij muaji. Ibn Huzejme dhe Bejhekiu shenojne nje transmetim nga Selman El-Faresiu r.a. i cili thote: Diten e fundit te muajit Sha'ban i Derguari i All-llahut s.a.v.s. na eshte drejtuar me nje ligjerat duke thene: "Njerez, po u vie nje muaj Madheshtor, muaj plot bereqet ne te cilin eshte nje nate e cila

eshte me e vlefshme se njemije muaj tjere".

All-llahu ne kete muaj e ka caktuar agjerimin si obligim te rrepte,ndersa namazi i teravise kryhet ne ato nete si forme vullnetare e ibadetit.Kush i afrohet Allahut me çfardo bamiresie vullnetare llogaritet si te kete kryer nje obligim te domosdoshme ne ndonje muaj tjeter.Ky eshte muaj i durimit.Do ti behet falje mekatesh dhe mbrojtje nga zjarri dhe do te fitoj shperblimin sa te agjeruesit duke mos u pakesuar shperblimi i ketij te fundit."

Ateher te pranishmit thane:"O i Derguar,nuk kemi te gjithë mundesi qe ti ushqejme agjeruesit."

Muhamedi s.a.v.s. ne kete u pergjigj:"Ai shperblim i takon edhe atij qe agjeruesi ia ofron edhe nje hurme,i jep uje te pije apo edhe nje gellejnke qumesht."

Ky eshte muaji,fillimi i te cilit eshte meshire,mesi eshte falje mekatesh,ndersa fundi lirim nga zjarri.Perpiquni qe ne kete muaj ti punoni kater gjera:dy me te cilat u jane te nevojshme,madje te domosdoshme.

Dy gjerat me te cilat do te arrini kenaqesine e Allahut jane:

- a)qe te deshmoni se nuk ka te adhuruar tjeter perveç Allahut dhe
- b)te kerkohet ndjese prej Tij.

Dy te tjerat qe u jane te domosdoshme jane qe:

- a)Allahun ta lutni tua dhuroje xhenetin dhe
- b)tiu mbroje nga zjarri.

Ai qe agjeruesit i jep te pije,Allahu do ti jep nga burimi i Tij ashtu qe nuk do ta marre etja deri sa te hyje ne Xhennet.."

Ky hadith i Pejgamberit s.a.v.s. na e sqaron rendesine dhe vleren e ketij muaji,gjithashtu na i cek disa nga veçoritë e ketij muaji,duke na nxitur ne kete menyre qe te mos leshojme rastin e perfitimeve te shumta qe na sjelle ky muaj.

-Prej veçorive me te cilat e veçoi Pejgamberi s.a.v.s. Ramazanin eshte se ky muaj eshte muaj i Madherishem dhe i begatshem dhe me te vertet keto dy cilesi e dallojne kete muaj nga muajt e tjere.

Cdo rast i ketij muaji eshte i madherishem dhe i begatshem ;begati ne kohe,begati ne pune dhe gjithashtu begati ne shperblim.

-Prej veçorive te ketij muaji eshte nata e Kadrit e cila eshte me e vlefshme se nje mije muaj,hashte ketij muaji.Kjo nate qe ne Kur'anin Famelarte eshte permendur per disa cilesi eshte nata ne te cilen ka zbritur Kur'ani i Madheruar,edhe sikur thote i Madhi All-llahu xh.sh:"Ne e zbritem ate(Kuranin) ne naten e Kadrit."Ne kete nate zbresin MelaiKET e Allahut me miresi nga Allahu xh.sh. dhe ne kete nate behet percaktimi vjetor qe do te ndodhe ne kete bote:"Në ate (nate) zgjidhet çdo qeshtje ne menyre te prere" (Ed-Duhan) , dhe kjo nate eshte cilesuar nga Allahu i Madherishem si nate e paqes dhe shpetimit. "Ajo (qe percakton Zoti) eshte paqe deri ne agim te mengjesit."(El-Kader:5) eshte e qarte se sa vlere te madhe qe ka kjo nate e ketij muaji,mirpo vlefshmeria e kesaj natee eshte per ate i cili kete nate e gjalleron me namaz dhe perkujtim te Allahut te Madherishem,me lexim te Kur'anit,me kerkim falje etj...

-Prej veçorive te tjera e shte obligueshmeria e agjerimit ne kete muaj,e agjerimi eshte nje prej pese shtyllave te kesaj feje te persosur(Islamit),

-Prej veçorive dhe vlerave te ketij muaji gjithashtu eshte edhe ajo se ne kete muaj veprat e mira shperblehen shumefish,me pune vullnetare ka shperblimin e nje pune

obligative(farzi) jashte ketij muaji kurse nje pune obligative(farz) ka shperblimi e 70 puneve obligative,jashte ketij muaji.

-Prej veçorive te ketij muaji eshte se ky muaj i durimit,qe do te thote frenim i epsheve me agjerim.Durimi eshte nje nder adhurimet me te veshtira per shpirtin e njeriut,dhe per kete qellim shperblimi per durimi eshte Xheneti.Allahu i madherishem thote:"Ndersa te durueshmeve i jepet shperblimi i tyre pa llogari(mase)".(Ez-Zumer,10).

-Poashtu ,prej veçorive te tjera te ketij muaji eshte se ky muaj ,eshte muaj i bujarise,e kjo bujaria eshte dy llojesh:

a)bujaria dhe miresia e Allahut xh.sh. per roberit e Tij.Kjo bujari e Tij manifestohet me faljen e mekateve dhe lirimin nga zjarri i Xhehenemit te besimtareve qe e meritojne kete.

b)bujaria e njerezve ne mes veti.Kjo bujari ndernjerezore manifestohet me barazine ndermjet tyre,sepse ne kete muaj te gjithë jane te barabarte,si i bardhi si i ziu,si i pasuri si i vaerferi,te gjithë permbahen nga ushqimet,pijet ,frenimi i epsheve te tyre me nje qellim qe eshte adhurimi per Allahun xh.sh. Pastaj kjo bujari verehet edhe ne solidaritetin e te pasurve ndaj te varferve,me dheninen e sadekul-fitrit,zekatit dhe ndihmvaë tjera,dhenien e iftarve per agjeruesit si dhe butesia ndaj robit dhe sherbetorit.

-Prej veçorive te ketij muaji eshte se ky muaj eshte i meshires se njerezve ndermjet veti,dhe i zbritjes se meshires mbi ta nga i Gjithmeshirshmi.Prandaj ne kete muaj verejme se i pasuri eshte i meshirshem ndaj te varferit,i forti e meshiron te dobetin,sunduesi e meshiron ate qe e ka nen sundimin e tij,e ata qe jane te meshirshem,do to meshiroje i Gjithmeshirshmi.

-Prej veçorive te tjera te ketij muaji eshte edhe se miresite ne kete muaj jane shumellojesh,pjesa e pare e ketij muaji eshte meshire,pjesa e dyte falje mekatesh,kurse fundi i ketij muaji lirim nga zjarri i Xhehenemit.

-Prej veçorive tjera te ketij muaji jane:

- Era e gojes se agjeruesit eshte me e mire dhe me e dashur tek Allahu se era e miskut(parfumit).

-Allahu nuk e refuzon lutjen e atij qe eshte agjerueshem.

-Ne kete muaj hapen dyerte e Xhenetit.

-Ne kete muaj mbyllen dyerte e Xhehenemit.

-Melaiket kerkojne falje nga Allahu per agjeruesit.

-Djajte prangohen me pranga te hekurta.

-Naten e fundit te ramazanit besimtareve u falen mekatet e tyre.

Edukimi i femij eve ne Ramazan



Femijet te cilet nuk kane arritur moshen e pubertetit nuk e kane te obliguar agjerimin. Mirpo, prinderit apo kujdestaret e tyre jane fuqishem te rekomanduar qe ti inkuarajojne femijet e tyre qe te agjerojne disa dite, keshtu qe ate te rriten dhe te mesohen me adhurim dhe agjerim, ashtu siç mesohen me namaz. Ne fakt ,kjo ka qene e praktikuar per here te pare ne Islam, nga nje grua

qe jetonte ne rrethin e Muhamedit a.s.


Fjala eshte per Rabia bint Mavih, e cila thoshte se :I Derguari i Allahut xh.sh. e dergoi nje njeri ne ditën e ashures ne rezidencen e ensareve. Ai tha: "Kush do qe ka kaluar mengjesin e ashures agjerueshem, e ka kompletuar agjerimin e tij. Kush nuk e ka agjeruar kete mengjes, duhet ta zevendsoje me nje agjerim vullnetar".

Pas kesaj ne agjeruam ditën e ashures ashtu siç ben edhe femijet tane. Ne duhej te shkonim ne xhami dhe te merrim lodra me vete. Nese ndonjeri prej femijeve qante per shkak te urise, ne i jepnim lodra per ta qetesuar deri sa vinte koha per te ngrene.

Prinder te nderuar, perkujtoni se ne mesin e shtate personave (vetav) qe Allahu xh.sh do ti marre nen hijen e Tij, do te jete i riu qe eshte rritur ne adhurim ndaj Allahut xh.sh. Prandaj ,le te jete ffemiju juaj njeri prej tyre.

Ka shume menyra per ti edukuar femijet rreth Ramazanit, menyra me e mire dhe me e rendesishme eshte qe ti japim shembull te mire si duhet te agjerojne dhe te veprojne sipas mesimeve te te Derguarit a.s. Kjo eshte e para gje qe femijet tuaj.

DOBITE SHENDTETSORE TE AGJERIMIT



Shumica e muslimaneve nuk agjerojne per dobi shendetesore. Ata agjerojne sepse kjo iu eshte urdheruar atyre me Kur'an. Dobite mjekesore te agjerimit jane rezultat i vet agjerimit. Ne pergjithesi agjerimi eshte paktikuar ne mjekesi per arsye shendetesore; duke perfshire ketu rregullimin e peshes trupore, qetesim te traktit digjestiv si dhe per uljen e yndymave. Ka shume dallime mes agjerimit total dhe te ashtuquajturve dietave te pjeshme.

Agjerimi ne Islam eshte krejt i ndryshem nga çdo diete e planifikuar, sepse me agjerimin e Ramazanit nuk ka keqperdorim te ushqimit apo marrje te kalorive joadekuate. Marrja e kalorive gjate Ramazanit per muslimanet eshte pak nen nivelin e kerkesave te zakonshme ditore. Veç kesaj, agjerimi i Ramazanit eshte veprim vullnetar e jo pershkrim detyrimor nga fiziatri.

Ramazani eshte muaj i vete-rregullimit dhe vete-ushtimit, me shprese se ky ushtrim do tia arrije qellimit ne fund te Ramazanit. Ne qofte se mesimet e marra gjate Ramazanit; marrja e dietave te rregullta mbahen pas Ramazanit, kjo do te jete shpetim per tere jeten. Per me teper, menyra e te ushqyerit gjate Ramazanit nuk ka ndonje kriter te veçante te dietes se pjeshme, siç jane: ushqimi vetem me proteina, vetem me fruta apo ndonje ip te veçante te ushqimit. Ne Ramazan çdo gje qe eshte e lejueshme merret ne mase mesatare. I vetmi ndryshim mes agjerimit te pjeshem dhe Ramazanit eshte koha e ushqimit. Gjate Ramazanit ne në fakt nuk hame dreke dhe mengjes hame heret dhe nuk hame deri ne iftar.

Largimi nga uji gjate kohes se agjerimit, s'eshte i keq. Ne fakt kjo gje shkakton konzervimin e fluideve ne tere trupin duke zvogeluar dihidrimin e tij. Trupi ka mekanizmin e tij te mbrendshem per konzervimin e ujit. Eshte vertetuar se zvogelimi i dehidrimit, se paku te bime, rrite jetegjatesin e tyre.

Efektet fiziologjike te agjerimit perfshijne; uljen e sheqerit ne gjak, uljen e kolesterolit dhe uljen e shtypjes sistolike te gjakut. Ne fakt agjerimi i Ramazanit do te ishte nje rekomandim ideal per tretman te bute, te noderruar, srsabil te diabetit, dhjamit dhe hipertensionit.

Me 1994 ne kongresin e pare nderkombetar mbi shendetin dhe Ramazanin te mbajtur ne Kasablank, u prezantuan 50 shkrime nga e gjithe bota. Hulumtues musliman dhe jomusliman sollen studime te gjera rreth etikes mjekesore te agjerimit. Shumica e vleresimeve ishin se ne asnje menyre agjerimi nuk ka ndikim negativ ne shendet.

Ne anen tjeter eshte vertetuar se pacientet qe vuajne nga semundjet e renda, siç jane :diabeti apo semundjet koronarearterike, guret ne veshke etj., agjerimi ka ndikim negativ

dhe keta paciente jane te liruar nga agjerimi dhe nuk duhet ta praktikojne ate.

Poashtu agjerimi ka edhe efekte psikologjike.Eshte nje paqe dhe qetesi per ata qe agjerojne gjate muajit te Ramazanit.Armiqesia personale eshte ne minimum dhe shkalla e krimeve bie.Muslimanet marrin keshille nga i derguari a.s i cili ka thene:"Nese dikush fjaloset me ju apo ju sulmon ;thuaj:une jam agjerueshem".

Gjendja psikologjike mund te jete e lidhur per stabilizimin me te mire te glukozes ne gjak gjate agjerimit.Hipoglikemia pas ngrenies,ndikon negativisht ne sjelljen e njeriut.Vlen te theksohet efektet e dobishme bga lutja shtese e nates.Kjo jo vetem qe ndihmon ne te tretjen me te mire te ushqimit ,por edhe zberthimin e tij.Zberthen 10 kalori te veçante per çdo rekate te namazit.Prape, ne nuk bejme namazin per ushtrime,por nje levizje e qete e nyjeve me perdorimin e kalorive te duhura eshte nje forme me e mire e ushtrimeve.Thjesht ,leximi i Kur'anit nuk eshte vetem qetesues per zemer dhe mendje,por e zhvillon intelegjencen.

Nga kjo une i inkurajoj pacientet musliman qe te agjerojne muajin e Ramazanit,por ata duhet ta bejne kete nen perkujdesin mjeksor.Muslimanet e rritur dhe te shendosh nuk duhet te frikesohen nga dobesimi gjare agjerimit ,po ne vend te kesaj duhet ta ngrisin shendetin e tyre dhe qendrueshmerin.

ASPEKTET MJEKESORE TE AGJERIMIT NE ISLAM

Ka me shume se nje miliard musliman ne bote,perfshire ketu edhe 8 milion ne Ameriken Veriore.Shumica e tyre e zbatojne agjerimin gjate muajit Ramazan.Ata agjerojne jo per te humbur peshe apo per ndonnje dobi tjeter mjekesore,por sepse agjerimi u eshte urdheruar me Kur'an:"O ju qe keni besuar,agjerimi u eshte bere obligim,sikur qe ishte oblihim per ata qe ishin para jush".Kur'an:2:183


Duke u bazuar ne ligjin Islam,femijet nen moshen 12 vjeçare,te semuret ,udhtaret,grate te cilat jane me menstarucione,lehonat,nenat me femije ne gji jane te liruar nga agjerimi.Agjeruesit,perveç qe jane te obliguar ti shmangen ushqimit dhe pijeve,ata jane te obliguar te largohen edhe nga mardheniet intime,pirja e duhanit,sjelljet e pahijshme mbrenda kohes sa jane agjerueshem.Veç kesaj gjate Ramazanit,ata duhet te shtojne devotshmerin;duke shtuar namazet,bamiresin,leximin e Kur'anit,dhe te gjitha veprimet e mira.

Ushqimi eshte i nevojshem per ti siguruar trupit energji per shfrytezim te menjehershem.Kjo behet me tretjen e karbohidrateve,siç eshte sheqeri i zakonshem.Teprica e Karbohidrateve te cilat nuk mund te shfrytezohen jane te deponuara si shtese ne indin muskolor dhe si glikogjen ne melqi per shfrytezim ne te ardhmen.

Insulina;hormon i pankerasit,rregullon nivelin e sheqerit ne gjak dhe si rezultat edhe glikogjeni ne melqi.Qe te jete efektiv insulina duhet te kete lidhje me vende tjera te quajtura "pranues-akceptor". Njerezite qe kane dhjam iu mungojne akceptoret ,ose i kane te bllokuar .Prandaj nuk mund ti perdorin insulinat e tyre.Kjo mund ti shpie glikozat ne jotolerance.Kur dikush agjeron ose zvoglon ne menyre drastike marrjen e karbohidrateve,kjo shkakton uljen e sheqerit dhe insulines ne gjak.Kjo shkakton renjen e glikogjenit nga melqia,si pasoje pamundeson sigurimin e sasise se mjaftueshme te glykozes dhe zvogelon yndyren nga indet dhajmore;poashtu te nevojshme per energji trupore.Na bazat e fiziologjise njerezore jane pershkruar keto qe u thane me larte.Dietat e

pjesshme apo kotogjenike jane trilluar per efikasitetin e kontrollimit te peshes.Keto dieta sigurojne vleresimin e shumes se proteinave ne doze te ndara me disa gllenjka uji,multivitamina etj.Keto efektivisht e zvoglojne peshen dhe sheqerin ne gjak ,por per shkak te efektit anesor te tyre,duhet te perdoren nen mbikeqyrjen e fiziologeve.

STUDIME NE AGJERIMIN ISLAM



Dr.Sulejmani nga spitali Universitar i Amanit ne Jordani raporton se ka bere studime tek 2 meshkuj .muslimanet vullnetar dhe te shendoshe te cilet ishin te moshes 15 dhe 64 vjeçare,dhe 26 femra 16 deri 28 vjeçare.Studimet jane bere ne Ramazan te vitit 1404 Hixhri(perkatesisht ne Qershor-Korrik 1984).Atyre iu eshte matur niveli i kolesterolit ne gjak,testostaromit.Na,K,Urese,Glukoza,Kolesteroli ne gjak,densiteti i larte lipoproteinor(HDL) densiteti i ulet lipoproteinor(LDL),trigliceritet etj.Osmoliteti i smeureve eshte matur ne fillim dhe ne fund te Ramazanit.Gjate matjeve eshte verjetur nje renie e peshes tek meshkujt prej 73.8 ± 4.8 deri 54.6 ± 4.2 kilogram(me pak se 0.05).Glukoza ne gjak eshte rritur prej 77.7 ± 23.6 mg/dl deri 84.5 ± 11.1 mg/dl(me pak se 0.002).Parametrat tjere nuk kane treguar ndonje ndryshim te dukshem.

Ndersa studimet e Dr.F.Azizi dhe asocacionet e tij nga universiteti i Shkencave mjekesore ne Teheran(Iran)sollen keto te dhena:

Niveli i serumit per glukoze,biluridin,Ca,P,Proteina,albumine,FSH,LH,testosteron,produktin TSH,T5H,T4,T3;ishin te barabarta ne grupin e 9 meshkujve te shendetshem para dhe ne ditën e 10-te,20-te dhe 29-te.D.m.th pesha trupore ka rene prej 65.4 ± 9.1 ne 61.6 ± 9.0 kg. ne ditën e 29-te Glukoza ne Serum ka rene prej 82 ± 4 mg/dl ne ditën e 10-te eshte rritur pastaj 76 ± 4 dhe 84 ± 5 ne ditën e 20 -te dhe 29-te te agjerimit.Biliuridini eshte rritur prej 0.56 ± 0.17 deri 1.43 ± 0.52 mg/dl ne ditën e 10-te dhe ka rene pastaj(1.1 ± 0.4 ne iten e 20-te dhe 29-te).Te gjitha ndryshimet jane kthyer ne vleren baze pas 4 jave agjerimi.Nuk eshte verejtur ndonje ndryshim ne nivelin Ca,P,proteinave,albumines apo ndonje hormoni tjeter.Prolaktina,TSH,ishin poashtu te pandryshuara.

Ai konkludoi se:

- a)Abstenimi apo largimi nga ushqimi dhe pijet per 17 ore ne dite mbrenda 29 diteve nuk e nderron gjendjen e hormoneve reproduktive mashkullore e as metabolizmin periferik te hormneve tiroide,dhe se
- b)mbrojtja fizike.Muslimanet duhet te jene te vetedijshem per rendesine e ndryshimit te glukozes dhe biluridinit gjate Ramazanit.

Nga dy sttudimet e pershkruara me larte,konkludojme se agjerimi nuk shkakton ndonje kunderefekt medicinal,perkundrazi ,ka efekte te dobishme ne peshe dhe metabolizmin e lipideve.

AGJERIMI PER PACIENTET-KESHILLA UDHEZUESE PER PACIENT

Siç kemi cekur me larte,te semuret jane te liruar nga agjerimi.Por disa per çfrado arsye,vendosin qe ti nenshtrohen agjerimit.

PACIENTET DIABETIK-Diabetiket te cilet mbajne diete te vetekontrolluar mund te agjerojne me shprese,se me redukcion te dobet semundja e tyre bile mund te kurohet(mjekesohet) apo se paku te vertetohet.Diabetiket te cilet marrin hapa kunder sheqerit te larte hipoglikemise,duhet ti nenshtrohen rregullave ekstreme nese ata vendosin te agjerojne.Ata do te duhej te zvogelojne dozen e tyre prej 1-3 dhe te marrin medikamente jo ne mengjes,por ne mbremje ne kohen kur perfundon agjerimi.Nese verehen simtome te rritjes se shtypjes ne gjak gjate dites,ata duhet te nderprejne agjerimin menjehere.Diabetiket te cilet marrin insuline nuk duhet te agjerojne .Nese ata rrezikojne ne kete dhe agjerojne ,duke rrezikuar shendetin e tyre,ata do te duhej te agjerojne nen tretmane te kontrolluara dhe te bejne ndryshime drastike ne dozen e e insulines .Per shembull ,ata duhet te eliminojne insulinen e rregullte dhe te marrin vetem NPH ne doze te ndara pas perfundimit te agjerimit ose pas syfyrit (mengjesit).

PACIENTET HIPERTENSIV DHE KARDIAK-Ata te cilet vuajne nga shtypja e larte dhe trashesia duhet te nxiten me agjerim ,sepse agjerimi do ti ndihmonte ne uljen e shtypjes se gjakut dhe peshes.Mirpo,te tille duhet te vizitohet mjekun e tyre gjate agjerimit qe te rregullojne trajnimin e diuretikeve(hapa qe largojne tepricen e ujit prej organizmit qe mund te qojne deri ne dehidrim).Faktoret me veprim te gjate si Tenorim mund te jepen nje here ne dite para ngrenies se ushqimit.Ata qe jane me hipertension te rrepte apo me semundje te zemres nuk duhet te agjerojne.

MIGRENA-KOKEDHEBJA-edhe gjate tensionit te kokedhembjes,dehidrimi apo sheqeri i ulet ne gjak do te ngacmoj simptome e migrenes.Gjate agjerimit ndodhe ne rritje e acideve te lira ne gjak te cilat drejte perdrejt do te afektojne ne ashpersim apo vrullin e migrenes nepermjet lirimit te katekolamines.Pacientet me kokedhembje(migrene)eshte e parapelqyer qe te mos agjerojne.

GRUAJA SHTATEZENE-(shtatezani normale)-kjo nuk eshte nje gjendje e lehte.Shtatezania nuk eshte perjashtim i njejte.Nje perjashtim i tille nuk eshte i permendur ne Kur'an.Sidoqofte ,Muhamedi a.s. ka thene se grate shatezena dhe lehonat nuk e kane te obliguar agjerimin.Kjo eshte ne perputhje me ate se Allahu xh.sh nuk i deshiron askujt ,as edhe ne fetusi ,qe te vuaj.Nuk ka ndonje menyre per njohjen e demit qe i shkaktohet nje femiu te palindur deri ne lindje,dhe ajo do te mund te ishte teper vone .Sipas mendimit te obstrikeve,gjate trimestit te dyte (4-6)te shtatezanise ,gruaja mund te zgjedhe agjerimin me kushte qe:

- 1)shendeti i saj eshte ne rregull
- 2)eshte bere me miratimin e obstrikut dhe nen kushte te veçanta.Demi i mundshem ndaj fetusit mund te mos ndodhe nga malnutriumi,keshtu qe iftari dhe syfyri jane

adekuat,por demi ndodh nga dehidrimi ,nga largimi i gjate prej ushqimit(10-14 ore)
Eshte e rekomanduar qe te semurit musliman ,nese agjerojne ,ta bejne ate nen
perkujdesje mjekesore.

RENDESIA E HURMAVE PER SHENDETIN E NJERIUT



Muslimanet ne pergjithesi bejne iftar me ngrenien e hurmave.Transmetohet se i Derguari a.s. ka thene:"Nese ndokush nga ju eshte agjerueshem le te beje iftar me hurma,ne qofte se nuk ka hurma,ateher me uje.Vertet uji eshte pastrues".

Duke u bazuar ne disa transmetime i Derguari i Allahut a.s. perdorte hurma per te bere iftar para se te falte namazin e akshamit dhe nese hurmat nuk ishin te pjekura,apo nuk kishte fare hurma,ai perdorte si zevendesim rrush te terur.Kur keto te dyjanuk i kishte,ai pinte ca gellenjka uje.

Shkenca moderne ka vertetuar se hurmat jane pjese e te ushqyerit te shendetshem.Hurmat permbajne sheqer,yndyre dhe proteina,poashtu edhe vitamina te rendesishme.Keshtu edhe Muhamedi a.s. i ka kushtuar rendesi te madhe hurmave.Hurmat jane shume te pasura per nga ndertimi i tyre i mbrendshem.Mjekesia moderne ka treguar se ato jane mbrojtes nga kanceri abdominal.Hurmat gjithashtu i tejkalojne frutat e tjera per nga shumellojshmeria e perberjes.Ato permbajne yndyre,kalcium,sulfur,hekur,kalium,fosfor,mangan,baker dhe magnezium.Me fjale te tjera,nje hurme eshte minimumi i nje diete te shendoshe.Arabet zakonisht i kombinojne hurmat me qumesht dhe jogurt ose buke,gjalpe dhe peshke.Ky kombinim ne te vertet e bene dieten te vetemjaftueshme dhe te shijshme per mendjen dhe trupin.Rendesine e hurmes dhe drunjeve te tyre e tregon fakti se ato jane te pemendura me shume se 20 here ne Kur'nin Famelarte.

I derguari i fundit ,Muhamedi a.s. i krahasonte muslimanet e mire me drunjet e hurmave,duke thene:"Ne mes te drunjeve eshte nje dru,sikurse muslimani;gjethet e tij nuk bien".

Mjeremja,nena e Isait a.s. i ka perdorur hurma si ushqim te saj,kur ajo vuante nga dhimbjet e lindjes dhe gjate kohes kur ishte lehone.Ato jane perfundimisht "kurore embelsie" dhe ushqim ideal qe lehte tretet,dhe mbrenda gjysme ore pas ngrenies se tyre trupi i lodhur rigjenerohet dhe rimerr fuqine.

Vlene te theksohet se arsyeja kryesore pse njerezite ndejne uri eshte mungesa e sheqerit ne gjak e jo barku i zbrazet,siç mendohet.Kur trupi merr ushqim esencial prej disa hurmave ,ndjenja e urise behet e pandieshme.Kur ndokush e thene agjerimin me disa hurma dhe mmer ushqim tjetër pas kesaj,ai nuk do te jete ne gjendje per te ngrene shume.

Eksperimentet gjithashtu kane treguar se hurmat permbajne stimulues qe fuqizojne muskujt e uterusit ne muajin e fundit te shtatezanise.Kjo ndihmon ne dilatacionin (zgjerimin) e uterusit dhe ne te njejten kohe zvogelon gjakderdhjen pas nje lindje ne

tjetren. Dietiket konsiderojne se hurmat jane ushqimi me i mire per lehonat dhe ato qe jane duke i dhene gji femijes. Kjo sepse, hurmat permbajne elemente qe asistojne ne lehtesimin e depresionit te nenat dhe pasurojne qumeshtin e nenes me te gjitha elementet e nevojshme per ta bere femijen e shendoshe dhe rezistent ndaj semundjeve.

Institutet bashkohore per diete rekomandojne qe femijet te cilet ankojne nga nervoziteti natyror apo hiperaktiviteti te marrin hurma.

DISA QESHTJE GJATE MUAJIT TE RAMAZANIT

FUTJA E UJIT NE GOJE NGA AGJERUESI

Pyetje: Ne qofte se agjeruesi fut ujin ne goje a hunde dhe pastaj uji hyn ne fyt pa qellim, a priset agjerimi?

Pergjigje: Ne qofte se ai fut ujin ne goje a hunde dhe pastaj uji kalon mbrenda ne trup, agjerimi nuk priset, ngaqe kjo eshte bere pa qellim. Argument per kete jane fjalet e Allahut: "Mirpo ate qe paten per qellim zemrat tuaja".

MARRJA E GJAKUT NGA AGJERUESI

Pyetje: Si eshte vendimi i sheriatit per marrje te gjakut nga agjeruesi gjate Ramazanit per shkak te analizave mjekesore?

Pergjegje: Ky lloj i analizave nuk prish agjerimin ,sepse kete e ka bere per shkak te nevojës qe ka pasur, dhe kjo nuk hyn ne ato gjera qe prishin agjerimin ,te cilat jane cekur ne sheriatin e paster.

VENIA E BARNAVE ME PIKA NE SY A E PRISH AGJERIMIN?

Pyetje: A e prish agjerimin perdorimi i pikave ne sy?

Pergjegje: Perdorimi i pikave ne sy nuk e prish agjerimin ,edhe pse ne kete vendim ka mos pajtim mes dijetarësh ,saqe disa prej tyre thone se nese shija e tyre ndihet ne fyt prish agjerimin .Mirpo, e verteta eshte se kjo nuk e prish agjerimin ,sepse nuk mund te kaloje nga syri ne fyt. Pra mendimi i sakte eshte se kjo nuk e prish agjerimin ,pa marre parasysh a vendosen pikat ne sy a ne vesh.

VENDIMI I SHERIATIT NDAJ MARRJES SE INJEKSIONIT NE DITE TE RAMAZANI

Pyetje: A e prish agjerimin marrja e gjilperes ose injeksioni per shkak te semundjes?

Pergjegje: Injeksioni qe merret per sherim eshte dy llojesh: njeri ushqen trupin dhe kjo eshte sikurse te hash dhe te pish, prandaj ky lloj injeksioni prish agjerimin.

Ndersa lloji i dyte jane injeksionet qe merren per sherim, te cilat nuk ushqejne trupin ,prandaj ky lloj nuk e prish agjerimin ,meqe marrja e tij nuk ushqen trupin.

VENDIMI I SHERIATIT NDAJ AGJERUESIT QE HANE NE HARRESE

Pyetje:Cili eshte vendimi mi sheriatit ndaj agjeruesit qe ha ose pi ne harrese,dhe ai qe sheh agjeruesin duke ngrene a duke pire a duhet ta perkujtoje ate?

Pergjegje:Kush ha ose pi ne harrese,agjerimi i tij nuk priset.Mirpo sapo ti bjere ne mend ai duhet te largohet nga ushqimi,gjithashtu duhet te largoje edhe ate kafshate qe ka ne goje.

Allahu ju shperblefte per leximin e kesaj brochure.Ju bej ftese qe ta shperndani kete brochure sa me shume vellerzerve dhe motrave musliman.Allahu ju shperblefte.

www.Nur-Islam.Tk